

## VEPRIMTARIA E URDHRI TË FARMACISTEVE TË SHQIPËRISË PËR PERIUdhËN KORRIK - DHJETOR 2016

Bazuar në Neni 7 të Ligjit 9150 “Për Urdhrin e Farmacistëve në RSH” i ndryshuar, po iu dërgojmë raportin për veprimtarinë e 6-të mujorit të parë të UFSH-së për vitin 2016, sipas sektorëve përkatës.

### **Sektori i Antarësimit dhe Regjistrimit**

Gjatë këtyre muajve, puna pranë Sektorit Antarësimit dhe Regjistrimit, është zhvilluar në mbështetje të Ligjit Nr. 9150, datë 30.10.2003 “Për Urdhrin e Farmacistëve në Republikën e Shqipërisë”; neni 4, 5 dhe 6. të Statutit të Urdhrit të Farmacistëve, si dhe të ligjit Nr. 105/2014 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, ligjit Nr. 10171, dt 22.10.2009 “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”, si dhe Rregullores për Anëtarësimin e Farmacistëve, Regjistrimin e Ndhmës Farmacistëve dhe Funkcionimin e Regjistrit Kombëtar të Urdhrit të Farmacistëve të Shqipërisë.

Puna gjatë kësaj periudhe është zhvilluar në kuadër të përmbushjes të detyrave që i përkasin përgjegjëses së antarësimit dhe regjistrimit si:

- Udhëheqja dhe mbikqyrja e anëtarësimit të të gjithë farmacistëve në rang Republike.
- Udhëheqja dhe mbikqyrja e regjistrimit të të gjithë ndihmësfarmacistëve në rang Republike.
- Mbledhja e të dhënave në dosje të vecanta për secilin anëtar dhe vendosjen e tyre në kartotekën e Urdhrit.
- Hedhja e të dhënave të secilit farmacist në databazën kompjuterike.
- Përditësimi periodik i Regjistrit Kombëtar manual dhe atij kompjuterik.

- C'regjistrimi i farmacisteve në bazë të nenit 16 të Statutit.
- Përgatitja e raporteve të ndryshme mbi anëtarët e Urdhrit dhe vënia në dispozicion të sektorëve të ndryshëm të UFSH-së.

Veprimet e kryera në këtë periudhë pranë sektorit të antarësimit dhe regjistrimit, kanë konsistuar në ndryshime të pozicionit të punës të farmacistit të punësuar, drejtuesit teknik, ndryshim të vendit të punës nga i punësuar në drejtues teknik, anëtarësime të reja si dhe dorëzim të certifikatave.

Është vënë re një fluks i madh i ndryshimeve të vendeve të punës, ku përmendim:

- 60 raste të ndryshimit të vendit të punës për drejtuesin teknik,
- 49 raste të ndryshimit të pozicionit të punës nga i punësuar në drejtues teknik,
- 75 raste të ndryshimit të vendit të punës për farmacistin e punësuar,
- 27 raste të ndryshimit të pozicionit të punës nga drejtues teknik në të punësuar.

Ndërsa përsa i përket ndryshimeve të vendit të punës për ndihmës farmacistë janë vetëm 8 raste të ndryshimit të vendit të punës si drejtues teknik në Agjenci Farmaceutike.

Gjatë kësaj periudhe ka patur 26 anëtarësime të reja, prej të cilëve 2 anëtarësime pasive. Nga ana tjetër kemi 5 raste të kalimit nga anëtarë pasiv në aktiv.

Kemi pasur 34 raste të dorëzimit të certifikatave nga ana e drejtuesve teknik, për arsye të tërheqjes nga vendi i punës apo mbyllje të aktivitetit përkatës.

Nga ana tjetër përmendim edhe rastet e dypunësimit të farmacistëve të cilat shënojnë 34 raste për këtë periudhë.

Gjithashtu cdo fund muaji është hartuar raporti me ndryshimet e vendeve të punës së drejtuesve teknik, i cili i është dërguar Qendrës Kombëtare të Biznesit, me të gjitha të dhënat e drejtuesve teknik, të ndara sipas rasteve, drejtues teknik të cilët ndryshojnë vendin e punës, farmacistët të cilët kalojnë për herë të parë drejtues teknik nga të punësuar, si dhe drejtues teknik të cilët largohen nga farmacitë dhe dorëzojnë certifikatën pranë UFSH, me datat përkatëse.

### **Sektori I Mbikqyrjes Profesionale**

Gjatë vitit 2016, UFSH në përmbushje të detyrimit që i ngarkon ligji Nr. 9150, Date 30.10.2003 “Për Urdhrin e Farmacistëve të Shqipërisë”, i ndryshuar, ka kryer mbikqyrje profesionale në rreth 500 subjekte farmaceutike në shumicën e rajoneve të vendit. Problematika më shqetësuese që vazhdon të thellohet është dhënia e shërbimit farmaceutik nga persona jofarmacistë. Pavarësisht se në vijimësi ua kemi përcjellë këtë shqetësim Ministrisë së Shëndetësisë, AKBPM dhe Policisë së Shtetit.

Për vitin 2016 janë dërguar për në komisionet disiplinore 6 farmacistë, për të cilët jemi në pritje të vendimeve përkatëse.